

Drejtuar Komisionit Qendror të Zgjedhjeve

Kërkesë për plotësim me dokumentacion të formularit të dekriminalizimit

Ne respektim të ligjit nr.138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", si dhe Vendimit nr.17/2016 të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, kam dorëzuar formularin e vetëdeklarimit, në datë.....

Por, duke kuptuar se plotësimi i formularit duhej bërë vetëm për shkeljet/veprat e parashikuara sipas nenit 2 dhe 3 të ligjit dhe jo për cdo veprë apo shkelje/kundërvajtje të kryer gjatë jetës, kjo nga paqartësia që krijon vetë Formulari i vetëdeklarimit, i cili bën fjalë vetëm për vendimet e formës së prerë të gjykatave që kanë dënime me burgim, apo vendimet e gjykatave jo të formës së prerë që kanë dënime me burgim, më duhet të jap të dhëna më të plota, të cilat vërtetohen me vërtetimin e gjendjes gjyqësore dhe në vlerësimin tim nuk i referohen kushteve të ndalimit, sipas përcaktimeve të neneve 2 dhe 3 të ligjit, por që gjithsesi konstatoj se duhet të jenë pjesë e formularit.

Sqaroj se, me vendimin nr.779, datë 14.07.2006 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Tiranë jam deklaruar fajtor për veprën penale të kryerje së veprimeve arbitrare dhe në bazë të nenit 250 KP jam dënuar me gjobë, në vlerën 100.000 (njëqind mijë) lekë.

Me vendimin nr. 20, datë 17.01.2007 të Gjykatës së Apelit, Tiranë, i cili është vendimi i formës së prerë, është vendosur: "Prishja e vendimit nr. 779, datë 14.07.2006 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Tiranë dhe pushimi i gjykimit".

Bashkëngjitur do të gjeni vërtetimin e gjendjes gjyqësore.

Lutemi të pranoni dokumentat që po paraqes, të cilat do të jenë pjesë e formularit të vetëdeklarimit.

Me respekt,

Ndrec Dedaj.....



Adresa: Rr. "Abdi Toptani" (pranë Torre Drin) Tel / Fax: 00355 4 22 82 92

Nr. 1 Prot.

Tiranë më 18/05/2016

VËRTETIM
I GJENDJES GJYQËSORE

Në zbatim të nenit 484 të Kodit të Procedurës Penale, të Republikës së Shqipërisë, nga verifikimet që iu bënë shënimeve të regjistrin gjyqësor pranë kësaj Ministrie, rezultojnë se shtetasi (emri, mbiemri) NDREC DEDAJ

biri (e bija) i NDUE dhe i LIZA
01/01/1969 në Tirane

NE BAZE TE VENDIMIT NR.779 DT. 14/07/2006 GJYKATA E RRETHIT TIRANE E DEKLARON FAJTOR PER VEPREN PENALE TE "KRYERJES SE VEPRIMEVE ARBITRARE" DHE NE BAZE TE NENIT 250 K.P ESHTË DENUAR PERFUNDIMISHT ME 100 000 (NJËQIND MIJE) LEKE GJOBE.

GJYKATA E APELIT TIRANE ME VENDIMIN NR 20 DT. 17/01/2007 KA VENDOSUR PRISHJEN E VENDIMEVE DHE PUSHIMIN E CESHTJES PENALE.

(I PADENUAR)

ZYRA E GJENDJES GJYQËSORE

Elisabeta Skrapari

